

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Bazat e Auditimit të  
Brendshëm**

**B2**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

Data 10.10.2020

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Crumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

1. Fushëveprimi i punës për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e një programi të siguri dhënies dhe përmirësimit të cilësisë (QAIP) përfshin cilin nga proceset e mëposhtme?
  - I. Mbikëqyrja
  - II. Vlerësimi i brendshëm
  - III. Monitorimi i vazhdueshëm
  - IV. Vlerësimi i jashtëm
  - a) Vetëm I
  - b) I dhe II
  - c) I, II dhe III
  - d) Të gjitha**
2. Cila nga opsionet e mëposhtme është unike për vlerësimin e jashtëm të aktiviteteve të auditimit të brendshëm në krahasim me vlerësimin e brendshëm?
  - a) Gjetjet
  - b) Përfundimet
  - c) Rekomandimet
  - d) Opinioni i përgjithshëm**
3. Cila nga opsionet e mëposhtmet mund të përdoret nga një rishikues i jashtëm i pavarur kur përcaktohet fusha e vlerësimit të jashtëm të veprimtarisë së një auditimi të brendshëm?
  - a) Përqindja e planit të auditimit të përfunduar në një vit nga auditimi i brendshëm.
  - b) Numri i gjetjeve të raportuara në një vit nga auditimi i brendshëm.
  - c) Përqindja e programit të siguri dhënies dhe përmirësimit të cilësisë (QAIP) i zbatuar nga auditimi i brendshëm.**
  - d) Numri i rekomandimeve të auditimit të pranuar në një vit nga të audituarit.
4. Statuti i auditimit të brendshëm normalisht kërkon që aktiviteti i auditimit të brendshëm të përqendrohet në fushat që përbëhen nga cila nga sa më poshtë?
  - a) Rrezik i lartë i qenësishëm dhe rrezik i lartë residual.**
  - b) Rrezik i lartë i auditimit dhe rrezik i lartë aktual.
  - c) Rrezik i ulët i qenësishëm dhe rrezik i ulët i auditimit.
  - d) Rrezik i ulët i qenësishëm dhe rrezik i lartë i mbetur.
5. Kërkimi i një procesi të "pranimit të projektit" kur auditorët e brendshëm janë të përfshirë në projektin e një njësie biznesi, mund të zbusë cilën nga rreziqet e mëposhtmet?
  - a) Rreziku i biznesit.
  - b) Dështimet e auditimit.
  - c) Sigurimin fals nga auditimi.**
  - d) Rrezikun e reputacionit të auditimit.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

6. Një ekip i auditimit të brendshëm kohët e fundit përfundoi një auditim të pajtueshmërisë së kompanisë me politikën e saj të marrjes me lizing kundrejt blerjes në lidhje me automjetet e kompanisë. Raporti i auditimit vuri në dukje se baza për disa vendime për marrjen me lizing sesa për blerjen e automjeteve nuk ishte dokumentuar dhe nuk ishte e kontrollueshme. Raporti përmbante rekomandimin që menaxhmenti operativ të sigurojë që marrëveshje të tilla të lizingut të mos ekzekutohen pa dokumentacionin e duhur të bazës për vendimin për marrjen me lizing sesa të blerjes. Auditorët e brendshëm do të kryejnë punën vijuese (follow-up) në këtë raport të auditimit.

Supozoni se menaxhmenti i lartë ka vendosur të pranojë rrezikun e përfshirë në mos dokumentimin e bazës për marrje me lizing kundrejt vendimeve të blerjes që përfshijnë automobila të ndërmarrjes. Në një rast të tillë, cili do të ishte detyrimi raportues i auditorëve?

**a) Auditorët nuk kanë përgjegjësi të mëtutjeshme raportuese.**

- b) Vendimi i menaxhmentit dhe shqetësimi i auditorëve duhet t'i raportohen bordit të drejtorëve të kompanisë.
- c) Auditorët duhet të lëshojnë një raport vijues për menaxhmentin duke treguar qartë arsyet për rekomandimin që baza e marrjes me lizing kundrejt vendimeve të blerjes të dokumentohet si duhet.
- d) Auditorët duhet të informojnë auditorin e jashtëm dhe çdo agjenci përgjegjëse rregullatore se nuk është ndërmarrë asnjë veprim në lidhje me gjetjen në fjalë.

7. Gjatë një takimi të planifikimit në fund të vitit me menaxhmentin e lartë, drejtori ekzekutiv i auditimit (CAE) mëson se një draft raport i fundit i auditimit në një nga sistemet e kostos së inventarit të kompanisë kishte provokuar një diskutim në fushën e kontabilitetit. Raporti i auditimit propozoi një rregullim relativisht të madh për shkak të një gabimi në sistemin lokal të inventarit. Konkluzioni i auditorit deklaroi se gjashtë pajisje të tjera prodhuese që përdorin të njëjtin sistem të kostos do të kërkonin rregullime të ngjashme të inventarit. Rregullimi i përgjithshëm i kërkuar për të shtatë vendet përfaqësonte një rregullim material të pasqyrave financiare, sipas zyrtarit kryesor financiar (ZKF). ZKF vuri në dyshim metodën e përdorur nga auditori për të llogaritur shumën e rregullimit të inventarit dhe kërkoi nga CAE që të vonojë përpunimin e raportit të auditimit derisa të gjitha aspektet e gjetjes të konsiderohen plotësisht. CAE raporton drejtpërdrejt tek ZKF. Komiteti i auditimit nuk është njoftuar për këtë auditim sepse raporti i auditimit është ende në fazën e hartimit në pritje të komenteve të menaxhmentit.

Duke supozuar se CAE ka një takim më vonë të njëjtën ditë me komitetin e auditimit të bordit, cila nga këto nuk është përgjegjësi e drejtorit të auditimit të brendshëm?

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

- a) Informoni komitetin e auditimit për vendimet e menaxhmentit të lartë për të gjitha gjetjet e rëndësishme të auditimit.
  - b) Theksoni gjetjet dhe rekomandimet e rëndësishme të auditimit dhe raportoni mbi orarin e aprovuar të punës së auditimit.
  - c) Informoni komitetin e auditimit për rezultatin e takimeve të mëparshme me ZKF dhe opsionet që po merren parasysh për regjistrimin e rregullimit të inventarit.**
  - d) Tentoni të zgjidhni çështjen e inventarit përpara raportimit të gjetjeve në komitetin e auditimit.
8. Menaxhmenti i ka kërkuar departamentit të auditimit të brendshëm të kryejë një auditim operacional të operacioneve të marketingut telefonik të një divizioni kryesor dhe të rekomandojë procedurat dhe politikat për të përmirësuar kontrollin e menaxhimit mbi operacionet. Auditori duhet:
- a) Mos pranoj angazhimin sepse rekomandimet e kontrolleve do të dëmtonin objektivitetin e ardhshëm të departamentit në lidhje me këtë departament të audituar.
  - b) Mos pranoj angazhimin sepse departamentet e auditimit supozohet se kanë ekspertizë mbi kontrollet e kontabilitetit, jo kontrollet e marketingut.
  - c) Pranoj angazhimin, por të informoj menaxhmentit se rekomandimi i kontrolleve do të dëmtonte pavarësinë e auditimit në mënyrë që menaxhmenti të dijë që auditimet e ardhshme të zonës do të dëmtohen.
  - d) Pranoni angazhimin e auditimit sepse pavarësia nuk do të cenohet.**
9. Një ndërmarrje e mesme në pronësi publike që operon në Vendin X është rritur dhe drejtorët e korporatës besojnë se garanton krijimin e një departamenti të auditimit të brendshëm. Vendi X ka kërkesa ligjore sa i përket auditimit të brendshëm për kompanitë në pronësi publike. Kompania ndryshoi aktet nënligjore të sajat për të pasqyruar krijimin e departamentit të auditimit të brendshëm. Drejtorët vendosën që drejtori ekzekutiv i auditimit (CAE) duhet të jetë një Auditor i Brendshëm i Çertifikuar (ABC) dhe do t'i raportojë drejtpërdrejt komitetit të auditimit të sapo krijuar të bordit të drejtorëve.
- Cila nga pikat e diskutuara më sipër do të kontribuojë më shumë në pavarësinë e drejtorit ekzekutiv të auditimit të ri?
- a) Themelimi i departamentit të auditimit të brendshëm dokumentohet në aktet nën-ligjore të kompanisë.
  - b) Kërkesat e ligjore të auditimit të brendshëm në vendin X.
  - c) Fakti që CAE do t'i raportojë komitetit të auditimit të bordit të drejtorëve.**
  - d) Fakti që CAE duhet të jetë një Auditor i Brendshëm i Çertifikuar.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

10. Raportimi tek menaxhmenti i lartë dhe bordi është një pjesë e rëndësishme e detyrave dhe përgjegjësive të auditorit. Cila nga pikat e mëposhtme NUK kërkohet të raportohet tek menaxhmenti i lartë dhe/ose bordi?
- a) **Pas përfundimit të një auditimi, por para lëshimit të një raporti të auditimit, auditorit të lartë përgjegjës për auditimit iu ofrua një pozicion i përhershëm në departamentin audituar.**
  - b) Një përmbledhje e raportit vjetor të orarit të punës së auditimit dhe buxhetit financiar të departamentit.
  - c) Ndryshime të rëndësishme të ndërmjetme në orarin e miratuar të punës së auditimit dhe buxhetin financiar.
  - d) Një plan auditimi u miratua nga menaxhmenti i lartë dhe bordi. Pas miratimit, menaxhmenti i lartë informoi drejtorin ekzekutiv të auditimit që të mos kryejë një auditim të një sektori, sepse aktivitetet e divizionit ishin shumë të ndjeshme.
11. Sipas Standardeve IIA, personeli i një departamenti të auditimit të brendshëm të sapo zhvilluar duhet të përfshijë:
- a) Anëtarët me diploma bachelor në kontabilitet dhe fusha të ngjashme.
  - b) Anëtarët që posedojnë emërtime të përshtatshme profesionale.
  - c) **Anëtarët e aftë në zbatimin e standardeve, procedurave dhe teknikave të auditimit të brendshëm.**
  - d) Anëtarët me përvojë paraprake të auditimit të brendshëm.
12. Cila nga veprimtaritë e mëposhtme të komitetit të auditimit do të ishte në përfitimin më të madh për departamentin e auditimit të brendshëm?
- a) Rishikimi dhe miratimi i programeve të auditimit.
  - b) Siguria që auditori i jashtëm do të mbështetet në punën e departamentit të auditimit të brendshëm kur është e mundur.
  - c) Rishikimi dhe miratimi i të gjitha raporteve të auditimit të brendshëm para publikimit të tyre.
  - d) **Mbështetje për ndjekjen e duhur të rekomandimeve të bëra nga departamenti i auditimit të brendshëm.**
13. Sipas standardeve të IIA, dokumentacioni i kërkuar për të planifikuar një projekt të auditimit të brendshëm duhet të përfshijë evidenca që:
- a) Gjetjet e pritshme u identifikuan qartë.
  - b) Burimet e departamentit të auditimit të brendshëm janë të angazhuara në mënyrë efektive dhe efikase.
  - c) Puna e planifikuar e auditimit do të përfundojë me kohë.
  - d) **Burimet e nevojshme për të kryer auditimin janë konsideruar.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

14. Kur vlerësohet pavarësinë e një departamenti të auditimit të brendshëm, një ekip i vlerësimit të cilësisë konsideron disa faktorë. Cili nga faktorët e mëposhtëm ka më së paku ndikim kur gjykohet pavarësia e një departamenti të auditimit të brendshëm?
- Kriteret e përdorura në përcaktimin e detyrave të auditorëve.
  - Shtrirja e trajnimit të auditorit në aftësitë e komunikimit.**
  - Marrëdhënia midis letrave të punës së auditimit dhe raportit të auditimit.
  - Gjykimet e drejta dhe të paanshme të auditimit.
15. Cila nga pohimet e mëposhtme NUK është e vërtetë në lidhje me vlerësimin e rrezikut si term që përdoret në auditimin e brendshëm?
- Vlerësimi i rrezikut është një proces gjykues për caktimin e vlerave monetare në nivelin e perceptuar të rrezikut që gjendet në një aktivitet të auditueshëm. Këto vlera lejojnë drejtorët të zgjedhin të audituarit që ka më shumë gjasa të rezultojnë në kursime të identifikueshme nga auditimi.**
  - Shefi ekzekutiv i auditimit duhet të përfshijë informacione nga një larmi burimesh në procesin e vlerësimit të rrezikut, duke përfshirë diskutimet me bordin, menaxhmentin, auditorët e jashtëm dhe rishikimin e rregulloreve dhe analizën e të dhënave financiare/operative.
  - Vlerësimi i rrezikut është një proces sistematik i vlerësimit dhe integritit të gjyqimeve profesionale në lidhje me kushtet e pafavorshme të mundshme dhe/ ose ngjarjet, për të shërbyer si mjet për organizimin një orar të auditimit të brendshëm.
  - Si rezultat i një auditimi ose sondazhi paraprak, shefi ekzekutiv i auditimit mund të rishikojë nivelin e rrezikut të vlerësuar të një të audituari në çdo kohë, duke bërë rregullimet e duhura në orarin e punës.
16. Standardet e IIA kërkojnë që një auditor të ketë njohuri, aftësi dhe disiplinë, thelbësore për të kryer një audit të brendshëm. Cili nga sa më poshtë përshkruan saktë nivelin e njohurive ose aftësive të kërkuara nga Standardet? Auditorët duhet të kenë:
- Aftësi në zbatimin e njohurive të standardeve dhe procedurave të auditimit në situata specifike pa pasur nevojë për mbështetje të gjerë të kërkimit teknik dhe ndihmës.**
  - Aftësi në zbatimin e njohurive të kontabilitetit dhe sistemeve të kompjuterizuara të informacionit për probleme specifike ose të mundshme.
  - Një kuptim i teknikave të gjera të përdorura në mbështetjen dhe zhvillimin e gjetjeve të auditimit dhe aftësinë për të hulumtuar procedurat e duhura të auditimit që do të përdoren në çdo situatë auditimi.
  - Njohuri të gjerë për parimet dhe teknikat e kontabilitetit kur auditohen të dhënat financiare dhe raportet e organizatës.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

17. Departamenti i auditimit të brendshëm për një zinxhir të dyqaneve me pakicë së fundmi përfundoi një auditim të rregullimeve të shitjeve në të gjitha dyqanet në rajonin juglindor. Auditimi zbuloi se disa dyqane i kushtojnë kompanisë rreth 85,000 EUR për tremujor nga kreditmi i dyfishtë në llogaritë e klientëve.
- Raporti i auditimit, i publikuar tetë javë pas përfundimit të auditimit, përfshinte rekomandimet e auditorëve të brendshëm për menaxhimin e dyqaneve që duhet të parandalonin kreditimin e dyfishta në llogaritë e klientëve.
- Cili nga standardet e mëposhtëm për raportim është shpërfillur në rastin e mësipërm?
- Veprimet pasuese nuk ishin adekuate.
  - Auditorët duhet të kishin zbatuar veprimet e duhura korrigjuese sapo të zbuloheshin kreditë e dyfishta.
  - Rekomandimet e auditorit nuk duhet të përfshihen në raport.
  - Raporti nuk ishte publikuar në kohë.**
18. Cila nga strukturat e mëposhtme të raportimit do të përshkruante më së miri udhëzimet organizative të auditimit të brendshëm që përmbajnë Standardet IIA?
- Nga ana administrative tek bordi i drejtorëve, funksionalisht tek shefi ekzekutiv.
  - Nga ana administrative tek të audituarit, funksionalisht tek zyrtari kryesor financiar.
  - Nga ana administrative tek shefi ekzekutiv, funksionalisht tek bordi i drejtorëve.**
  - Nga ana administrative tek shefi ekzekutiv, funksionalisht tek auditori i jashtëm.
19. Standardet e IIA kërkojnë politika dhe procedura të shkruara për të udhëzuar stafin e auditimit. Cila nga pohimet e mëposhtme është e gabuar në lidhje me këtë kërkesë?
- Forma dhe përmbajtja e politikave dhe procedurave të shkruara duhet të jenë të përshtatshme me madhësinë e departamentit.
  - Të gjitha departamentet e auditimit të brendshëm duhet të kenë një manual të detajuar të politikave dhe procedurave.**
  - Manualet zyrtare administrative dhe teknike të auditimit mund të mos jenë të nevojshme nga të gjitha departamentet e auditimit të brendshëm.
  - Një departament i vogël i auditimit të brendshëm mund të menaxhohet në mënyrë joformale përmes mbikëqyrjes së ngushtë dhe memorandumeve të shkruara.
20. Sipas Standardeve të IIA, roli i auditimit të brendshëm në hetimin e mashtrimit përfshin të gjitha sa vijon përveç:
- Vlerësimin të nivelit të mundshëm dhe shkallës së bashkëpunimit në mashtrim brenda organizatës.
  - Hartimin të procedurave për t'u ndjekur në përpjekjen për të identifikuar autorët, masën e mashtrimit, teknikat e përdorura dhe shkaqet e mashtrimit.
  - Koordinimin të aktiviteteve me personelin menaxhues, këshilltarin ligjor dhe specialistë të tjerë të përshtatshëm gjatë gjithë hetimit.
  - Marrja në pyetje e autorëve të dyshuar të mashtrimit.**



Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

21. Politikat dhe procedurat e një organizate janë pjesë e sistemit të saj të përgjithshëm të kontrolleve të brendshme. Funkzioni i kontrollit i kryer nga politikat dhe procedurat është:
- a) **Kontrolli parandalues (feed-forward)**
  - b) Kontrolli i zbatimit.
  - c) Kontrolli reagues (feedback)
  - d) Kontrolli i aplikimit.
22. Refuzimi i modifikimeve të paautorizuara në sistemet e aplikimit mund të arrihet përmes përdorimit të:
- a) Kontrolleve të programuara
  - b) Kontrolleve të grupeve
  - c) **Kontrolleve të zbatimit**
  - d) Kontrollit një - nga - një
23. Për t'u siguruar që mallrat e marra janë të njëjta me ato të faturara në faturën e blerjes, një sistem i kompjuterizuar duhet të:
- a) **Përputh fushat e zgjedhura të faturës së blerjes me mallrat e marra.**
  - b) Mbaj totalin e kontrollit të vlerës së inventarit.
  - c) Llogarit totalin e grupeve për secilin hyrje.
  - d) Përdor shifrat e kontrollit në numrat e llogarisë.
24. Cili nga kontrollet e mëposhtëm do të ishte më efikas në zvogëlimin e gabimeve të zakonshme të futjes së të dhënave?
- a) Verifikimi i kreut dhe i fundit..
  - b) **Set i kontrolleve të editimeve të dizajnuara mirë.**
  - c) Balancimi dhe rekonsilimi
  - d) Totalët e grupeve.
25. Në një ndërmarrje të mesme është kryer një mashtrim kur nëpunësit të kontabilitetit iu ngarkua shumë përgjegjësi. Gjatë vitit, kompania kaloi furnizuesit e një shërbimi tek një shitës i ri. Nëpunësi i kontabilitetit vazhdoi të paraqesë fatura mashtruese nga furnizuesi i vjetër. Meqenëse kontraktimi për shërbimet dhe miratimi i faturave të furnizuesit i ishin deleguar nëpunësit, ishte e mundur që ai të vazhdonte të faturonte nga furnizuesi i vjetër dhe të depozitonte çeqet pasuese, të cilat ai ishte përgjegjëse për t'i paguar në një llogari të re që hapi në emër të furnitorit të vjetër. Nëpunësi u konsiderua si një punonjës i shkëlqyeshëm dhe përfundimisht iu dha në mënyrë të papërshtatshme përgjegjësia shtesë për përgatitjen e buxheteve të departamentit. Kjo përgjegjësi e shtuar e lejoi atë që në fakt të buxhetonte për shumën e pagesave mashtruese.
- Cila nga procedurat e mëposhtme të auditimit ka shumë të ngjarë të çojë në zbulimin e mashtrimit?



Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

- a) **Merrni një mostër të faturave të paguara dhe verifikoni marrjen e shërbimeve nga departamentet e përfshira.**
- b) Gjurmoni një mostër të çeqeve të disbursuara me faturat e aprovuara për shërbimet.
- c) Kryeni barazimin e deklaratave bankare dhe llogarive për të gjitha çeqet e papaguara.
- d) Gjurmoni një mostër të dokumenteve të pranuar me faturat dhe çeqet e disbursuara.

26. Një agent i blerjeve bleu sende për përdorim personal me fondet e kompanisë. Kompania lejoi punonjësit e caktuar të blinin mallra nën kontrata të hapura në shumë monetare prej EUR 250 në ditë. Është kërkuar miratimi i mbikëqyrës të blerjeve, por ai informacion nuk i është komunikuar shitësit. Në vend të rishikimit dhe autorizimit të çdo porosie blerjeje, mbikëqyrësit rregullisht nënshkruan fletën e autorizimit në fund të muajit pa shqyrtuar ndonjë nga dokumentacionet mbështetëse. Meqenëse blerjet e kësaj natyre nuk ishin subjekt i politikave normale të pranimit të mallrave të ndërmarrjes, punonjësi i pandershëm i mori furnizimet në magazinën e shitësit. Të gjitha blerjet ishin për artikuj rutinë të porositur nga kompania. Gjatë vitit të kaluar, punonjësi grumbulloi mjaft mallra për të filluar një biznes të printimit dhe fotokopijimit. Në momentin që auditori i brendshëm të jetë i sigurt që po ndodh ky mashtrim, çfarë duhet të bëjë auditori pastaj?

- a) Raportoni menjëherë çështjen te zyrtari përkatës për zbatimin të ligjit, pasi që përfshihet një krim i mundshëm.
- b) Mos thuaj asgjë tani, por përfshij një përkrahje të dyshimit për mashtrim në auditim.
- c) **Raportoni menjëherë çështjen tek niveli i duhur i menaxhmentit.**
- d) Diskutoni menjëherë çështjen me punonjësin e dyshuar për mashtrim në mënyrë që të konfirmoni gjetjet e auditimit.

27. Cila nga opsionet e mëposhtme është e saktë lidhur me llojet e kontrolleve sipas dimensioneve të ndryshme kohore?

- a) **Kontrollet paraprake, Kontrollet e ndërkohshme dhe Kontrollet pasuese**
- b) Kontrollet parandaluese, Kontrollet zbuluese dhe Kontrollet korigjuese
- c) Kontrollet e kombinuara dhe Kontrollet plotësuese
- d) Kontrollet kompenzuese dhe Kontrollet kontradiktore

28. Anulimi i transaksioneve dhe Inkriptimi i të dhënave janë kontrolle:

- a) **Parandaluese**
- b) Zbuluese
- c) Korigjuese
- d) Zbuluese dhe Korigjuese

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

29. Kujt i takon përgjegjësia përfundimtare për vënien në zbatim të kontrolleve që janë efektive për sa i takon kostove, si për sistemet manuale ashtu edhe për ato të automatizuara.
- Bordit të drejtorëve
  - Drejtorit financiar
  - Komitetit drejtues për teknologji informative
  - d) Menaxhmenti që është përgjegjës për operacionet**
30. Vlera e shtuar ekonomike EVA është një teknikë e kontrollit financiar e cila prek pak a shumë të gjitha elementet që mund të realizojë një kompani për të shtuar vlerën e përfutur nga aktivitetet e saj. EVA mund të përcaktohet si:
- Vlera e të gjitha aksioneve të shitura plus borxhi i kompanisë
  - b) Vlera neto (pas tatimeve) e fitimit operativ të kompanisë minus koston e kapitalit të investuar në pasuritë e trupëzuara të kompanisë**
  - Të ardhurat neto minus kthimin nga investimet
  - Fitimi operativ kompanisë pjesëtuar për pasuritë minus detyrimet afatshkurta
31. Kush ka përgjegjësinë kryesore në përcaktimin e tonit në krye të një ndërmarrjeje i cili ndikon mbi integritetin, etikën dhe faktorët tjerë të një mjedisi pozitiv të kontrollit?
- Zyrtari Kryesor financiar CFO
  - Drejtori ekzekutiv i auditimit CEA
  - c) Krye shefi Ekzekutiv CEO**
  - Bordi i Drejtorëve
32. Caktimi i autoritetit dhe përgjegjësive, si dhe Grupet e mbikëqyrjes janë përbërësit kryesor të cilit standard të kontrollit të brendshëm të COSO-s:
- a) Mjedisit të Kontrollit**
  - Vlerësimi të rrezikut
  - Aktivitetet e kontrollit
  - Informimit dhe Komunikimit
33. Ndjeshmëria e një pohimi të menaxhmentit ndaj anomalive materiale, duke supozuar se nuk ka politika, struktura të kontrollit ose procedura të brendshme përkatëse është rrezik i:
- a) Vetvetishëm**
  - Kontrollit
  - Auditimit
  - Mbetur/ rezidual

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

34. Menaxhimi i rrezikut ndahet në dy kategori. Cila nga opsionet e mëposhtme paraqet kategoritë e sakta të ndarjes së menaxhimit të rrezikut:
- a) Vlerësimi i rrezikut dhe Eliminimi i rrezikut
  - b) Eliminimi i rrezikut dhe Financimi i rrezikut
  - c) Financimi i rrezikut dhe Monitorimi i rrezikut
  - d) Kontrolli i rrezikut dhe Financimit rrezikut**
35. Menaxhmenti i një kompanie të sigurimit të pasurive është i shqetësuar për efikasitetin dhe efektivitetin e aktiviteteve të përpunimit të dëmeve. Ka dy shqetësime kryesore: (1) Disa kërkesa janë duke u paguar që nuk duhet të paguhen ose po paguhen në shuma më të mëdha se polisa; dhe (2) shumë pretendues nuk po paguhen në kohë. Gjatë përgatitjes për një auditim të fushës, auditori i brendshëm vendos të kryejë një studim paraprak për të mbledhur më shumë informacion në lidhje me natyrën e përpunimit dhe problemet e mundshme. Auditori zhvilloi një intervistë me mbikëqyrësin. Auditori vuri në dukje se mbikëqyrësi nuk u dje rahat dhe ishte nervoz dhe ndryshoi temën sa herë që auditori ngriti pyetje në lidhje me lloje të caktuara të pretendimeve. Përgjigjet e mbikëqyrësit ishin në përputhje me politikat dhe procedurat e kompanisë. Kur dokumenton intervistën, auditori duhet të:
- a) Dokumentoj përgjigjet e mbikëqyrësit, duke i kushtuar vëmendje natyrës së komunikimit joverbale.**
  - b) Mos dokumentoj komunikimin joverbal sepse është subjektiv dhe nuk është i vërtetuar.
  - c) Përfundoj që komunikimi joverbal është bindës dhe se ekzistojnë prova të mjaftueshme për të akuzuar mashtrim ndaj grupit.
  - d) Injoroni përgjigjet specifike të dhëna në intervistë, sepse ato janë vetëshërbyese.
36. Menaxhmenti u përgjigj "po" në çdo pyetje kur plotësoi një pyetësor të kontrollit të brendshëm dhe deklaroi se të gjitha kërkesat e listuara dhe aktivitetet e kontrollit ishin pjesë e procedurave të kompanisë. Një auditor i brendshëm e ka marrë këtë pyetësor nga menaxhmenti gjatë vizitës paraprake, por nuk i ka shqyrtuar përgjigjet me menaxhmentin ndërsa ishte në terren. Mbikëqyrësi i auditorit duhet të jetë kritik ndaj procedurës së mësipërme bazuar në faktin se:
- a) Informacioni i auditimit duhet të vërtetohet në një farë mënyre.**
  - b) Nuk mund të mbështetemi në pyetësorët e kontrollit të brendshëm.
  - c) Auditorët nuk ishin të pranishëm ndërsa po plotësohej pyetësori.
  - d) Pyetësori nuk ishte krijuar për të adresuar operacionet dhe kontrollet e kontabilitetit.
37. Cila nga pohimet e mëposhtme përshkruan një pyetësor të kontrollit të brendshëm? Ajo:
- a) Ofron evidenca të hollësishme në lidhje me përmbajtjen e sistemit të kontrollit.
  - b) Merr më pak kohë për të përfunduar nga të auditorit sesa pajisjet e tjera të vlerësimit të kontrollit.
  - c) Kërkon që auditori të jetë i pranishëm për ta administruar siç duhet.
  - d) Siguron prova indirekte të auditimit që mund të kenë nevojë për vërtetim.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

38. Cila nga teknikat e mëposhtme mund të përdoret për të vlerësuar devijimin standard për një plan të marrjes së mostrave?
- Vlerësimi i ndryshimit
  - Mostra pilot**
  - Regresioni
  - Mostra e zbulimit
39. Identifikimi i një popullate të përshtatshme për të marrë mostër varet nga objektivat e auditimit. Një popullatë e regjistrimeve të shpenzimeve të riparimeve të asetëve në një skedar do të ishte një popullatë e përshtatshme nëse objektivi i auditimit do të ishte të përcaktonte nëse:
- Shpenzimet për asetet fikse nuk janë regjistruar në mënyrë të duhur.**
  - Shpenzimet e riparimeve jokapital janë ngarkuar si duhet në shpenzim.
  - Shpenzimet e riparimeve jokapital janë regjistruar në periudhën e duhur.
  - Shpenzimet për asetet fikse janë regjistruar në periudhën e duhur.
40. Për të testuar pajtueshmërinë me politikën në lidhje me kthimin e mallrave të shituara të regjistruara gjatë vitit të fundit, një auditor përzgjedhi sistematikisht 5% të kthimeve aktuale të regjistruara në Mars dhe Prill. Kthimet e mallrave të shitura gjatë këtyre dy muajve më të ngarkuar të vitit përfaqësuan rreth 25% të kthimeve totale vjetore. Parashikimet e gabimeve nga kjo mostër kanë dobësi të kufizuar sepse:
- Madhësia e vogël e mostrës në raport me popullatën e bën të papranueshëm rrezikun e marrjes së mostrës.
  - Dështimi për të shtresuar popullatën sipas vëllimit të shitjeve rezulton në paragjykim.
  - Përzgjedhja sistematike e kthimeve gjatë dy muajve nuk është mjaft e rastësishme.**
  - Shkalla e gabimeve gjatë dy muajve më të ngarkuar mund të mos jetë përfaqësuese e të gjithë vitit.
41. Gjatë auditimit të stoqeve, një auditor i brendshëm specifikoi saktësinë prej 5% në vend të saktësisë prej 4% të përfshirë në programin e auditimit paraprak. Cili do të ishte ndikimi i ndryshimit në saktësi?
- Një rënie në devijimin standard të popullsisë.
  - Një rritje në devijimin standard të popullsisë.
  - Një rënie në madhësinë e kërkuar të mostrës.**
  - Një rritje në madhësinë e kërkuar të mostrës.
42. Bazuar në një mostër të rastësishme, vlerësohet se 4%, plus ose minus 2%, e faturave të një firme përmbajnë gabime. Plus ose minus 2% njihet si vlerësimi:
- Përpikërie**
  - Saktësie
  - Niveli i besimit
  - Gabim standard

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

43. Një auditor i brendshëm me një kompani ndërkombëtare transporti duhet të marrë në provë të dhënat e transportit gjatë gjashtë muajve të fundit. Për ta bërë këtë, auditori tërheq një mostër të rastësishme për anijet që veprojnë në Mesdhe dhe një mostër të veçantë për ato që veprojnë në Atlantikun e Veriut. Kjo metodë e marrjes së mostrave quhet:

- a) Mostrimi i grupeve
- b) Mostrimi haphazard
- c) Marrja e mostrave në interval
- d) Mostrim i shtresëzuar**

44. Një auditor ka marrë një mostër të attributeve të portofolit ekzistues të kredive të një banke. Nga një mostër prej 60 kredive, auditori gjen:

- Katër kredi nuk ishin kolateralizuar siç duhet.
- Pesë kredi nuk janë në përputhje me politikat e bankës (përveç mungesës së kolateralizimit).
- Katër kredi ishin pjesë e një grupi të ndërlidhur, por u krijuan si kredi të subjekteve të veçanta.

Nga 60 kreditë e zgjedhura në mostër, këto gabime u vunë re në një total prej dhjetë kredish.

Disa kredi kishin probleme të shumta. Cilin nga përfundimet e mëposhtme mund të arrijë auditori nga këto gjetje?

- I. Ka prova të mjaftueshme se aktiviteti mashtrues po zhvillohet nga një ose më shumë zyrtar të kredive të bankës.
- II. Pasqyrat financiare do të keq-vlerësohen si rezultat i këtyre veprimeve.
- III. Ekzistojnë gjetje të rëndësishme të auditimit të mospërputhshmërisë që duhet të raportohen.

- a) I dhe II
- b) I dhe III
- c) II dhe III
- d) Vetëm III**

45. Cila nga procedurat e mëposhtme do të siguronte provat më të rëndësishme për të përcaktuar mjaftueshmërinë e lejimit për llogari të arkëtueshme të dyshimta?

- a) Konfirmimi i llogarive të arkëtueshme.
- b) Analiza e pagesave të muajit vijues në gjendjet e mbetura të llogarive të arkëtueshme.
- c) Testet e kontrolleve mbi fshirjen e llogarive të arkëtueshme për t'u siguruar që menaxhmenti miraton të gjitha fshirjet.
- d) Analiza e lejimit përmes moshimit të llogarive të arkëtueshmeve dhe të dhënave aktuale ekonomike**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

46. Provat që janë më të mirat në dispozicion dhe të besueshme janë të:
- Mjaftueshme
  - Kompetente**
  - Relevante
  - Dokumentuara
47. Kur përdoren metodat e marrjes së mostrave, koncepti i mjaftueshmërisë së provave do të thotë që mostrat e zgjedhura ofrojnë:
- Siguri të arsyeshme që mostrat janë përfaqësuese të popullatës nga e cila janë marrë.**
  - Provat më të mira që janë arsyeshëm të arritshme.
  - Siguri të arsyeshme që mostrat e marra kanë një lidhje logjike me objektivin e auditimit.
  - Siguri absolute që mostra është përfaqësues e popullatës.
48. Cila teknikë është më e përshtatshme për testimin e cilësisë së informacionit të marrë para auditimit të kuponëve të pagesave, të përshkruara në një pyetësor të kontrollit të brendshëm (ICQ)?
- Analiza
  - Vlerësimi
  - Verifikimi**
  - Vrojtim
49. Në vlerësimin e vlefshmërisë së llojeve të ndryshme të provave të auditimit, cili nga përfundimet e mëposhtëm është e pasaktë?
- Rillogaritja, megjithëse është mjaft e vlefshme, është e kufizuar në dobishmëri për shkak të fushës së saj të kufizuar.
  - Vlefshmëria e provave dokumentare është e pavarur nga efektiviteti i sistemit të kontrollit në të cilin u krijua.**
  - Provat dokumentare të krijuara nga brenda konsiderohen më pak të vlefshme sesa provat dokumentare të krijuara nga jashtë.
  - Vlefshmëria e konfirmimeve ndryshon drejtpërdrejt me pavarësinë e palës që merr konfirmimin.
50. Një auditor i brendshëm po diskuton një problem të auditimit me një palë të audituar. Ndërsa dëgjon të audituarin, auditori i brendshëm duhet të:
- Përgatis një përgjigje ndaj të audituarit.
  - Mbaj në mend komunikimin joverbal të folësit, pasi është më i rëndësishëm se sa ajo që thuhet.
  - Sigurohet që të mbaj në mend të gjitha detajet, si dhe idetë kryesore të të audituarit.
  - Harmonizoj informacionin e ri nga i audituari me informacionin që tashmë dihet.**